



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Pristina Obština-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

K O N T R A T Ë

Numri i kontratës:¹ 616-24-3024-5-1-1/C1486

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëjërën anë; dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik Beni Construction SH.P.K.; BK - CONSTRUCTION SH.P.K.; N.N.P. EURO CONSTRUCTION, rr.Ismail Dumoshi, Prishtinë, Kosovë, me nr. të regjistrimit e biznesit NUI 810063925 e përfaqësuar nga Arben Shahini (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

TITULLI: "101 Rikonstruimi i Platos në lagjen Dardania, rruga Bill Clinton (tek Santea)

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **101 Rikonstruimi i Platos në lagjen Dardania, rruga Bill Clinton (tek Santea)**

No.	numër identifikues: 616-24-3024-5-1-1 dhe me nr te brenshem 616 24 039 511
1	101 Rikonstruimi i Platos në lagjen Dardania, rruga Bill Clinton (tek Santea)

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: 498,827.30 €; (Katërqindë e nëntëdhjet e tetmijë e tetëqindë e njëzet e shtatë Euro e tridhjetë cent Euro)

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.





Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin:	
Emri:	Visar Shehu	Emri:	ARBEN SHAHINI
Pozita:	Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit	Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	18.06.2024	Data:	18.06.2024
Vula:		Vula:	

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 616-24-3024-5-1-1/C1486

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 "Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "Skicat" nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruara dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontrakteton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njuh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

OBLIGIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet ti kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do ti jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbaje çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, ti kthej ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

OBLIGIMET E KONTRAKTUESIT

Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrimit. Ekzekutimi i urdhrimit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalojë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritet nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuara në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 11 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbrisë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 12 Programi

12.1 Brenda kohës së specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë së paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnoj Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rris detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 13 Siguria në vend punishte

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndalojë qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve të Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahen. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skermën dhe pajisjet e sigurisë të cilat janë të nevojshme për zbatimin e duhur të detyrave ose që me arsye mund të kërkohen nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 14 Ndërhyrja me trafikun

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tilla si rrugët, hekurudhat, rruge ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet në peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë te veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përforcuar pjesët e rrugëve, urave, do të bartet në shpenzime të Kontraktuesit, pa marre parasysh se ato kryhen nuk ato kryhen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin kontraktues për çfarëdo masa të veçanta që ai synon të ndërmarrë para se kryej ato. Riparimet e dëmit të shkaktuara në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

Neni 15 Tatimi

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

Neni 16 Kostoja e Riparimeve

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

FILLIMI DHE VONESAT

Neni 17 Fillimi i punëve

17.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

17.2 Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

Neni 18 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

18.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritset se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 18.2 Autoriteti Kontraktues do të lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Kontraktuesit.

19.2 Nëse Autoriteti Kontraktues ka fituar të drejtën e vlerës maksimale në bazë të nenit 19.1 ai mundet, pasi ta njoftojë Kontraktuesin:

- (a) konfiskoje garancinë e realizimit; dhe / ose
- (b) të ndërpresë kontratën; dhe
- (c) të hyjë në një kontratë me një palë të tretë në koston e Kontraktuesit për ofrimin e bilancit të punimeve.

MATERIALET DHE MJESHTËRITË

Neni 20 Regjistri i punës

20.1 Një regjistër i punës do të, përveç kur parashikohet ndryshe nga KVK, mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbaje të paktën informacionin e mëposhtëm:

kushtet e motit, ndërprerjet e punës që detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhëne Kontraktuesit;

deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave që duhet bere Kontraktuesit.

20.2 Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si pune ne progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar te dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon që të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënimet e paraqitura në regjistër. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marr një kopje të shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.

20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur.

Neni 21 Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve

21.1 Punët, komponentët dhe materialet do të jenë në përputhje me specifikimet, vizatimet, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë dhe do të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë gjithë periudhës së realizimit.

21.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare do të jenë objekt i një kërkesë të dërguar nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues. Kërkesa duhet ti referohet numrit të kontratës, numrin e Lotit dhe vendin ku do të zhvillohet pranimi i tillë, sipas rastit. Komponentët dhe materialet e specifikuara në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në pune.

21.3 Edhe nëse janë pranuar teknikisht materialet apo artikujt që do të përfshihen në pune ose në prodhimin e komponentëve, ato mund të refuzohen dhe duhet të zëvendësohen menjëherë nga Kontraktuesi nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime. Kontraktuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikuj do të pranohen për inkorporim në pune vetëm nëse janë riparuar.

Neni 22 Inspektimi dhe testimi

22.1 Autoriteti Kontraktues do të emëroj "Menaxherin e Projektit", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

22.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rena dakord.

22.3 Kontraktuesi do të sigurojë që komponentët dhe materialet të dorëzohen në kohë në vend për ti lejuar autoritetit kontraktues që të vazhdojë me pranimin e komponentëve dhe materialeve. Kontraktuesi konsiderohet se ka vlerësuar plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe nuk do ti lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë në përmbushjen e detyrave.

22.4 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë, ose nga vetë ose agjentit e tij, që të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë progresin e përgatitjes, fabrikimit apo

prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për ofrimin e sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojnë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vend-punishite ose në ndonjë vend tjetër, siç mund të specifikohet në kontratë.

22.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin ose do të miratojë certifikimin e procedurës lidhur me këtë.

22.6 Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do të japë një deklaratë për pikëpamjet e tij ndaj tjetrit brenda 15 ditëve pas ngritjes së mosmarrëveshjes së tillë. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, nga një ekspert që zgjidhet me pëlqimin e përbashkët. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë të Kontraktuesit. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e të cilit dëshmohet se është gabim nga ri-testimit.

Neni 23 Paralajmërim i hershëm

23.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vone në kualitetin e punëve.

23.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato në skica apo në specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitojë menjëherë dhe do t'i konsiderojë pasojat.

23.3 Nëse palët në kontratë vlerësojnë se ndërrimet substanciale të punëve janë bere të nevojshme për shkak të gabimeve të tilla ose të përjashtimeve të cilat substancialisht ndikojnë në çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do të korrigojnë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

PAGESAT

Neni 24 Pagesa

24.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

24.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do t'i paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

24.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhet nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

24.4 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

Neni 25 Paramasa dhe Parallogaria

25.1 Paramasa dhe parallogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe parallogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Parallogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbajë aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregojë shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 26 Parapagimi

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të

pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmojë se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

Neni 27 Mbajtja e Parasë

27.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve. Kjo shume në asnjë rast nuk do të tejkalojë 10% e vlerës totale të kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë e mbajtura me garancion bankar “me kërkesë”.

27.2 Shuma e mbajtur ose garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29.

Neni 28 Vërtetimet e pagesës

28.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a) Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Paralogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Paralogari që është përfunduar; ose
- b) Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

Neni 29 Llogaritja përfundimtare

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft të deklaratës së llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në detaje vlerën e punës së bërë në përputhje me kontratën, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatis deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës së llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- a) Shumen e cila sipas opinionit të tij duhet të paguhet sipas kontratës; dhe
- b) pas evidentimit të shumave të paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund të jete rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30 Shkaqet për kompensim

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa te jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose te riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Neni 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të porealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitivave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkakuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 616-24-3024-5-1-1/C1486

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit ekzekutimit është 10% i vlerës totale te kontrates ne afat prej 210 ditesh.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	<p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <ul style="list-style-type: none"> (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 te KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit te kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: <ul style="list-style-type: none"> (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 15 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës..
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 15 ditë kalendarike nga data e pranimit te kërkesës se Menaxherit te projektit.

Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 15 dite pas nënshkrimit të kontratës
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë: Plani dinamik max. 180 ditë Plani dinamik min. 90 ditë
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është: do të përcaktohet pas nënshkrimit të kontratës me vendim nga ZKA
Parimet e përgjithshme të pagesave	24	Autoriteti Kontraktues do të paguaj kontraktuesit vlerën e kontraktuar në situacione në vlera minimale nga 25.000,00 € e mësipër për punët e kryera dhe të konstatuara nga menaxheri i kontratës.
Parapagimi	26.1	
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës së kontratës. Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 të KPK. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë". Shuma e parave të mbajtura do të mbahet gjatë tërë periudhës së defekteve-sipas ofertës _____ vite .
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 dite kalendrike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Garancinë e punimeve min. 10 vite Garancinë e punimeve max. 20 vite
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara. Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e punëve, është vlera e punëve të kryera të pranueshme.

		marrëveshje te palëve automatikisht shkëputet kontrata dhe pasojnë dënimet për OE si: nuk paguhen mjete nga Komuna e Prishtinës për punët e pakryera dhe llogariten demet e shkaktuara për moskryerjen dhe zhegitjen e punimeve që i paguan punë kryesi dhe automatikisht i konfiskohet sigurimi i ekzekutimit shuma 10% e vlerës totale te kontratës në Komunen e Prishtinës
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën komerciale -Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>ose</p> <p>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>

Rikonstruimi i platos ne lagjen "Dardania", rruga "Bill Klinton" (tek Santea)

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

REKAPITULIMI		Gjithsej
Pos	Përshkrimi i pozicionit	
1	PUNËT PËRGATITORE	€ 39,475.00
2	PUNËT E DEMOLIMEVE DHE ZHVENDOSJEVE	€ 17,397.10
3	PUNËT E MVESHJES FINALE ME NËNSTRUKTURË	€ 303,508.40
4	PUNËT E ELEMENTEVE MIKROURBANE	€ 11,500.00
5	PUNËT E MBJELLJES SE DRUNJEVE DHE GJELBERIMIT	€ 14,423.75
6	PUNËT E INSTALIMEVE ELEKTRIKE	€ 57,081.00
7	PUNËT E DRENIMIT	€ 6,420.00
8	PUNËT E TJERA	€ 49,022.05
Vlera e përgjithshme e punimeve:		€ 498,827.30

Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
1	PUNËT PËRGATITORE (për zonën 1 dhe 2)				
1.1	Mobilizimi i ndërmarrjes për fillimin e punimeve në projekt. Furnizimi me material për vedosjen e tabelës në dy vende me emrat e investitorit, ndërmarrjes projektuese dhe ndërmarrjes ndërtuese, vlerës investuese dhe fillimin dhe mbarimin e projektit. Tabela duhet të punohet nga materialet e kualitetit të lartë dhe me shtyp të kualitetit të mirë për dukje të qartë nga distanca e largët. Të gjitha duhet të punohen me udhëzime nga mbikqyrësi i punimeve.	komplet	1.00	6,500.00	6,500.00
1.2	Ndërtimi i punishtës që përfshinë: a) Zyra e përkohshme e ndërmarrjes më së paku 2 ndarje, secila ndarje duhet të ketë së paku sipërfaqe S=12m², me një sanitare si dhe e kyçur në furnizimin me energji të pandërprerë elektrike dhe të ujit. Zyra duhet të ketë lidhje në kanalizimin publik funksional ose në një rezervuar ekologjik mobil b) Zyra për organin mbikqyrës (minimum S=16m²), një tavolinë pune me minimum 6 karriga pune për gjatë gjithë kohës së ndërtimit c) WC ekologjike mobile për stafin punues ekzekutiv për gjatë gjithë kohës së ndërtimit d) Furnizimi i zyrës me lidhje për komunikim: telefon, internet për gjatë gjithë kohës së ndërtimit.	komplet	1.00	6,500.00	6,500.00
1.3	Kontrollimi dhe evdntimi i instalimeve nëntoksore, zgjidhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit si dhe përpilimi i planit detal operativ që lidhet me procesin të ndërtimit. Në çmim të llogaritet edhe kosto eventuale e furnizimit të objekteve institucionale të prekura nga ndërtimi me të gjitha shërbimet publike: ujë sanitar, rrymë elektrike, largim të urave fekale si dhe me telefonin. Për të gjitha këto shërbime, kontraktori duhet të ofroj plan detal të furnizimit të përkohshëm të objekteve dhe për të gjitha hargjimet mban përgjegjesin kontraktusi, dmth. investitori nuk merr mbi vete kosto shtesë përveç çmimit që kontraktori oferton në këtë pozicion, investitori ka të drejtën e ndërmarrjes së hapave që të furnizoi vet institucionet publike dhe lokalet afariste përmes kontraktimit të një kontraktori tjetër, përmes një kontratë emergjente (një person tjetër juridik) dhe tërë koston do ta mbaj kontraktori i këtij pozicioni.	m²	3,795.00	2.00	7,590.00
1.4	Fiksimi i pikave kontrolluese gjeodezike si dhe sigurimi fizik i reperëve të rrejtës shtetërore. Në çmim të kalkulohet trasimi gjeodezik i vijave ku do të kaloj rrjeti hidroteknik: ujsjellësi, kanalizimi fekal dhe kanalizimi atmosferik, rrjeti elektrik (tensioni i lartë dhe i ulët)	m²	3,795.00	3.00	11,385.00
1.5	Shënjestimi i instalimeve nëntoksore të cilat nuk çvendosen nga pozicioni ekzistues. Të bëhet edhe shënjestimi i lokacionit para fillimit të punimeve ku parashihet lokacioni për ndërtimin e shetitores.	komplet	1.00	500.00	500.00
1.6	Përcjellja me matje gjeodezike gjatë gjithë kohës së punimeve.	komplet	1.00	2,500.00	2,500.00
1.7	Rrethimi i komplet (dhe parcial) punishtes në perimetrin e saj në mënyrë që mos të ketë qasje nga kalimtarët e rastit. Rrethimi të bëhet nga materialet përkatëse për këtë lloj pune d.m.th nga materialet përkatëse i cili lejon zhvillim normal të punimeve në gjithë orarin sipas kërkesave të investitorit.	komplet	1.00	2,500.00	2,500.00
1.8	Egzaminimi i materialeve dhe bazës së sheshit para dhe pas vuarjës në vepër të tyre si psh. tamponit, gurit dhe elementeve tjera të cilat planifikohen për shqyrtim në këtë projekt. Kontraktori është i obliguar që të sjellë ateste paraprake lidhur me origjinën e materialit para fillimit të punimeve sipas të gjithave specifikave të shenuara nga pozicionet e veqanta në bazë të emërimit të produkteve. Të gjitha produktet duhet të jenë me origjinë nga shtetet anetare të EU dhe USA dhe në asnjë mënyrë nga shtetet tjera. Për të gjitha keto do të ketë përkujdesje të veqantë nga projektanti dhe ekipi mbikqyrës.	komplet	1.00	2,000.00	2,000.00
Gjithsej pozicioni 1:					€ 39,475.00
2	PUNËT E DEMOLIMEVE DHE ZHVENDOSJEVE				
2.1	Demolimi i pllakave dhe skajoreve ekzistuese në shetitore. Pozicioni përfshinë edhe ngarkimin dhe transportin e materialit në deponi legale.	m²	2,199.00	3.00	6,597.00
2.2	Demolimi i pllakave ekzistuese në pasazhe. Pozicioni përfshinë edhe ngarkimin dhe transportin e materialit në deponi legale.	m²	551.00	3.00	1,653.00



2.3	Demolim i shtresës niveluse nën pllaka, në pasazhe. Pozicioni përfshinë edhe ngarkimin dhe transportin e materialit në deponi legale.	m ²	551.00	3.00	1,653.00
2.4	Demolimi i ulëseve ekzistuese. Pozicioni përfshinë edhe ngarkimin dhe transportin e materialit në deponi legale.	copë	2.00	250.00	500.00
2.5	Demolimi i shportave të mbeturinave ekzistuese, dhe largimi i tyre me transport deri në deponinë e përcaktuar.	copë	2.00	250.00	500.00
2.6	Demolimi i strehëve metalike ekzistuese si dhe dy shtyllave mbajtëse të konstruksionit. Pozicioni përfshinë edhe ngarkimin dhe transportin e materialit në deponi legale.	copë	2.00	250.00	500.00
2.7	Demolimi i tavaneve të lëshuara ekzistuese. Pozicioni përfshinë edhe ngarkimin dhe transportin e materialit në deponi legale.				
2.7.1	Pasazhi 1				
2.7.2	Pasazhi 2	m ²	73.12	5.00	365.60
2.7.3	Pasazhi 3	m ²	73.12	5.00	365.60
2.7.4	Pasazhi 4	m ²	78.83	5.00	394.15
2.7.5	Pasazhi 5	m ²	38.03	5.00	190.15
2.7.6	Pasazhi 6	m ²	27.02	5.00	135.10
2.7.7	Pasazhi 7	m ²	81.76	5.00	408.80
2.8	Gërryrja e terrenit me bager sipas nevojës (materiale të nënbazës), jo të nevojshme. Pozicioni përfshinë edhe ngarkimin dhe transportin e materialit në deponi legale.	m ³	93.33	5.00	466.65
2.9	Pastrimi i tullave në fasadë. Pozicioni përfshinë edhe restaurimin e tyre.				
2.9.1	Pasazhi 1				
2.9.2	Pasazhi 2	m ²	78.84	5.00	394.20
2.9.3	Pasazhi 3	m ²	133.70	5.00	668.50
2.9.4	Pasazhi 4	m ²	127.27	5.00	636.35
2.9.5	Pasazhi 5	m ²	24.40	5.00	122.00
		m ²	63.40	5.00	317.00
Gjithsej pozicioni 2					€ 17,397.10

3	PUNET E MVESHJES FINALE ME NENSTRUKTURE				
3.1	Ngjeshja e nënbazës ekzistuese, deri në arrijtje të ngjeshmërisë në shtypje 45MPa (pas largimit të kubëzave ekzistuese)	m ²	2,199.00	3.00	6,597.00
3.2	Furnizimi dhe vendosja e gjeotextilit 250gr/m ² në tërë sipërfaqet ku parashihet pllakosja	m ²	2,750.00	3.00	8,250.00
3.3	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit 0-16 mm, me trashësi t=15cm, (në gjendje të ngjeshur deri min. 45MPa).	m ²	329.00	25.00	8,225.00
3.4	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit 4-8mm, me trashësi t=3-5 cm (ndër sipërfaqen e pllakave). Shtresa e rërës duhet të jetë e niveluar.	m ²	110.00	20.00	2,200.00
	<p>Pllakë nga gurët natyral me dimensione 30x20x6 cm (Toleranca e trashësisë +/- 2 mm), shtresa e jashme prej rëre kuarci dhe agregateve të zgjedhura me cilësi të lartë. Shtresa e impregnimit min.4mm brenda pllakës. Pllakat janë të dizajnuara me kënde të përpunuara për estetikë të rafinuar dhe pjesë për distancim në përputhje me standardet e EU-së. Sipërfaqja e tyre është e trajtuar me një përzjerje të veçantë të rërës së kuarci dhe spërkatjes me pigmentet e oksidit të hekurit, e cila ju jep përshtatshmëri për përdorim në zona me trafik të ulët deri në mesëm automobilistik.</p> <p>Karakteristikat:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shtresa e përparme e ngjyrosur me pigmente oksid hekuri • Eliminimi paraqitjes së gëlqerës nëpërmjet hidrofobizimit të brendshëm • Pastrimi i sipërfaqeve me frekuentim të lartë, • Rezistenca ndaj zhvendosjes (VG4) • Rezistenca ndaj ngricave dhe kripës për shkrirje të akullit sipas kërkesave të procesit CDF-rezistencë ndaj motit ≤ 50 gr/m², sipas standardeve të EU. • Absorbimi i ujit nga kapllarët, sipas standardeve të EU. • Rezistenca ndaj rrëshqitjes (USRV), sipas standardeve të EU. • Rezistent ndaj goditjeve mekanike, ngarkesa e thyerjes 7.0 kN • Kapaciteti i ngarkesës: Përdorim për automjete deri në 3.5 tonë me volum të ulët trafiku. • Rezistencë ndaj gërryrjeve, sipas standardeve të EU. • Rezistenca ndaj makines për pastrim me presion të lartë • Shkalla e vështirësisë së largimit të gomave përtypëse e ulët 				



3.5	<p>• Qëndrueshmëri ndaj ujit me klor ,</p> <p>• Qëndrueshmëri ndaj rrezeve UV (qëndrueshmëri ndaj dritës së diellit) ,</p> <p>• Efekt i vërtetuar i Redunox (për pastrime të lehta nga ngjyra, balta, gjerat ushqimore, reshjet natyrore, gomave përtypëse, vajrat e ndryshem dhe duhet të largohen me lehtësi duke mos lënë mbetje tjera.) te gjitha njollat rezistuese duhet te largohen me uje dhe fshese me trajtim. Verejte: Redunox mundeson degradimin e oksideve te azolit, reduktimin e rritjes se algave, myshkut dhe kerpurdhave, zberthimin e substancave organike dhe vetepastrim. Te gjitha pikat e shenuara me larte te deshmohen me ateste te veqanta te standardeve te EU-se.</p> <p>Te gjitha punet duhet te kryhen ne pajtim me projektantin dhe ne udhezim te prodhuesit dhe te organit mbikqyres . Produkti duhet te jete me origjine nga vendet e EU dhe standard sipas standardeve te EU.</p> <p>Rëra e fugës e standardizuar është një gurë i thjeshtë i thyer dhe i thatë, me një granulacion prej 0-2 mm. Ajo përdoret për një gjerësi të fugës prej 5 mm. Ngjyra e pllakave përzgjidhet nga projektanti. Produkti duhet të jetë nga vendet e EU</p>				
3.5.1	Ngjyrë gri-argjent	m ²	1,631.00	92.00	150,052.00
3.5.2	Ngjyrë nuansa e gurit gëlqerorë	m ²	674.40	92.00	62,044.80
3.6	<p>Furnizimi dhe montimi i pllakave në hapësirat e pasazheve të objekteve me dimensione 59,4 x 39,4 x 2,9 cm. Betoni i punuar prej rërës së kuarcit të kualitetit të lartë sipas standardit. Betoni i ngjyrosur me pigment të oksidit të hekurit.</p> <p>Siperfaqja e pllakës ka ngjyre të hirët, të rrezatuar në mënyrë të hollë dhe e furçuar me disk të diamantit. • P-B-30:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rezistent ndaj ngricës dhe kripës së akullit, ngarkesa e lhyerjes 3,0 kN - Rezistenca ndaj përkuljes dhe rezistenca ndaj fërkimit sipas standardeve te EU - Rezistenca ndaj rrëshqitjes sipas Standardeve te EU: Vlera USRV = 55 <p>Duhet respektuar fuga minimale prej 5mm, sipas projektit. Për të arritur një adhesion të duhur në një ndërtim të lidhur, është e rëndësishme të sigurohet një lidhje e fortë duke aplikuar në mënyrë të plotë një lloj të përshatshëm ngjitësi, për shembull, Baumit FlexSteinkleber Weiss S1, me një spatulë me dhëmbë në anën e poshtme të pllakave, duke kujdesur që të mos ndikohet funksioni i drenazhit. Impregnimi Duoprotect DP30 redukton hyrjen e ujit dhe vajit dhe mbron nga mykja dhe algat.</p> <p>Pozicioni përfshinë edhe mbushjen e fugave me rërë. Rëra është një gurë i thjeshtë i thyer dhe i thatë, me një granulacion prej 0-2 mm. Ajo përdoret për një gjerësi të fugës prej 5 mm.</p> <p>Ngjyra e pllakave përzgjidhet nga projektanti. Produkti duhet të jetë nga vendet e EU</p>	m ²	580.00	80.00	46,400.00
3.7	<p>Furnizimi dhe montimi i skajoreve me dim. 100x8x25cm. Me një strukturë të sipërfaqes të barabartë dhe përpunim të këndeve. Produkti duhet te jete prodhuar me standarde të larta cilësore, duke u bërë rezistent ndaj kushteve të ashpra të dimrit, si ngrica dhe kripa sipas standardeve te EU. Pozicioni përfshinë edhe pjesën e betonit e cila shtrihet si nënbazë si dhe mbushjen e fugave.</p> <p>Produkti duhet të jetë nga vendet e EU</p>	m	118.98	20.00	2,379.60
3.8	<p>Furnizimi me material dhe punimi i shkallëve me pllaka të betonit. Pllakat montohen në beton gjysëm të thatë duke e lyer pllakën nga ana e poshtme me ngjitës në tërë sipërfaqen e sajë. Pozicioni përfshinë edhe mbushjen e fugave.</p> <p>Pllaka të mëdha betoni me dimensione 59,8x39,8x5cm. Shtresa e sipërme është e impregnuar me trashësi minimale 4mm. me shtresë kryesore kuarci e rezistent ndaj konsumimit dhe veti hidrofobike.</p> <p>Karakteristikat:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rezistenca ndaj fërkimit, rezistenca ndaj rrëshqitjes, • Fortësia në lërheqje gjatë përkuljes, • Rezistenca ndaj ngricës dhe kripërave të shkrires së akullit sipas normave te EU. • Efekt i vërtetuar i Redunox (për pastrime të lehta nga ngjyra, balta, gjerat ushqimore, reshjet natyrore, gomave përtypëse, vajrat e ndryshem dhe duhet të largohen me lehtësi duke mos lënë mbetje tjera.) te gjitha njollat rezistuese duhet te largohen me uje dhe fshese me trajtim. <p>Verejte: Redunox mundeson degradimin e oksideve te azolit, reduktimin e rritjes se algave, myshkut dhe kerpurdhave, zberthimin e substancave organike dhe vetepastrim.</p> <p>Te gjitha punet duhet te kryhen ne pajtim me projektantin dhe ne udhezim te organit mbikqyres. Produkti duhet te jete me origjine nga vendet e EU dhe sipas standardeve te EU.</p> <p>Rëra e fugës e standardizuar është një gurë i thjeshtë i thyer dhe i thatë, me një granulacion prej 0-2 mm. Ajo përdoret për një gjerësi të fugës prej 5 mm. Ngjyra e pllakave përzgjidhet nga projektanti. Produkti duhet të jetë nga vendet e EU</p>	m ²	217.00	80.00	17,360.00
			Gjithsëj pozicioni 3:	€	303,508.40



4	PUNET E FLEMNTEVE MIKROURBANE				
4.1	Furnizimi dhe montimi i ulëseve në hapësirat e percaktuara sipas projektit. Lloji ulëseve percaktohet nga projektuesi.				

4.1	<p>Ullëse muri me mbështetëse shpine, me gjatësi 1,82 metra, me materializim dru tropikal. Struktura e saj është kombinim aliazh alumini dhe konektorëve të çelikut të lidhur me lamelat prej druri me bulona prej çeliku inox. Struktura e çelikut është e mbrojtur me një shtresë zinku dhe një shtresë të dytë mbrojtëse të pluhurit-ngjyrë (teknologji elektrostalike). Korniza mbështetëse përbëhet nga aliazh alumini dhe konektorë të përkulur çeliku. Ullsja (pjesa e poshtme) formohet nga 7 lamela prej druri masiv me seksion katror dhe 2 lamela rrothore gjithashtu prej druri masiv me seksion katror. Mbështetësja e shpines përbëhet nga 6 lamela prej druri masiv me seksion katror dhe një lamelë shtesë e njëjtë. Druri duhet trajtuar kimikisht dhe të ngjyrosset me ngjyrë mbrojtëse në dy shtresa me (teknologji elektrostalike). Ankerimi bëhet në mur me ankerë me fileto M10, siç tregohet në vizatimet e ankerimit. Është thelbësore që të gjitha elementet e mobiljeve urbane të jenë të ankeruara siç duhet sipas udhëzimeve teknike të prodhuesit dhe projektit.</p> <p>Përzgjedhja e dizajnit dhe ngjyrës bëhet nga projektanti.</p> <p>Produkti duhet të jetë nga vendet e EU</p>	copë	2.00	2,500.00	5,000.00
4.2	<p>Furnizimi dhe montimi i shportave të mbeturinave në hapësirat e përcaktuara sipas projektit.</p> <p>-Koshi i rumbullakët tri pjesësh për mbeturinat e ndara, është i mbuluar me profile prej aliazh alumini dhe vjen me një strehë, duke ofruar një volum prej 3x50 litrash për secilin nga tre ndarjet. Koshi karakterizohet nga profilet e tij prej aliazh alumini dhe një strukturë çeliku që bashkohet përmes bullonave prej çeliku inox. Struktura e çelikut është trajtuar me një shtresë mbrojtëse zinku dhe një shtresë pluhuri-ngjyrë për rezistencë të lartë ndaj kushteve atmosferike. Korniza mbështetëse është bërë nga fleta e çelikut të salduar me prerje NC-lazer, ndërsa mbështetësit përfshijnë katër profile prej aliazh alumini. Brenda, koshet janë të bëra prej plastikës HDPE me një volum prej 3x50 litrash secila. Strehat janë të bëra prej plastikës HDPE me një volum prej 3x50 litrash secila. Strehat janë të bëra prej plastikës HDPE me një volum prej 3x50 litrash secila. Strehat janë të bëra prej plastikës HDPE me një volum prej 3x50 litrash secila. Strehat janë të bëra prej plastikës HDPE me një volum prej 3x50 litrash secila. Strehat janë të bëra prej plastikës HDPE me një volum prej 3x50 litrash secila.</p> <p>Përzgjedhja e dizajnit dhe ngjyrës bëhet nga projektanti.</p> <p>Produkti duhet të jetë nga vendet e EU</p>	copë	2.00	250.00	500.00
4.3	<p>Furnizimi dhe montimi i mbajtësve të biçikletave. I prodhuar nga aliazh alumini dhe projektuar për të mbajtur tre biçikleta. Të trajtohen me një shtresë pluhuri-ngjyrë. Trupi i mbajtësit është i bërë nga aliazh alumini, me dimensione prej 555x610x880mm. Për montimin, mbajtësi duhet të ankerohet në bazë prej betoni me ndihmën e ankerave të filetuara. Është thelbësore që të gjitha elementet e mobiljeve urbane të ankorohen siç duhet sipas udhëzimeve teknike të prodhuesit dhe projektit.</p> <p>Përzgjedhja e dizajnit dhe ngjyrës bëhet nga projektanti.</p> <p>Produkti duhet të jetë nga vendet e EU</p>	copë	2.00	2,500.00	5,000.00
4.4	<p>Furnizimi dhe montimi i mbajtësve të rampave dhe shkallëve. Rampat përbëhen nga gypa metalik ø 42mm nga inoxi me trashësi muri 1mm. Mbajtësja përbëhet prej dy gypave horizontal dhe me gypa vertikale në distancë max. 200 cm. Gypat (shtyllat vertikale) përfundohen në bazament betoni. Të gjitha punët bëhen në bazë të projektit dhe në konsultë me organin mbikqyrës.</p>	m'	40.00	25.00	1,000.00
				Gjithsej pozicioni 4	€ 11,500.00

5 PUNET E MBJELLJES SE DRUNJEVE DHE GJELBERIMIT					
5.1	<p>Furnizimi dhe mbjellja e gjelbërimit. Pozicioni përfshinë: Mirëmbajlja e drunjëve dhe shkurreve dekorative, përkatësisht: ujitja, plehërimi, krasitja dhe lufimi i sëmundjeve dhe dëmtuesve.</p> <p>Luftimi i sëmundjeve dhe dëmtuesve në rast të paraqitjes së ndonjë sëmundje ose dëmtuesi bimët duhet të spërkaten, me qëllim të evitimit të dëmtimit dhe tharjes së tyre. Mirëmbajlja duhet për një vit.</p>				
5.1.1	<p>Furnizimi, transporti dhe mbjellja e OSOJA- përzleje e barit për sipërfaqet në hije, i certifikuar. Mbillet në mars-prill ose gusht-shtator në thellësi 0,5 deri 1 cm. Sasia e nevojshme për 1 m² është 20-25 g. Pas mbjelljes bëhet ngjeshja me cilindra 30-50 kg të rëndë dhe ujitja me kujdes të shtuar. Toka në të cilën mbillet duhet paraprakisht të lavrohet në thellësi 20-25 cm, imtësohet dhe rrafshohet mirë, të jetë e pasur me materie ushqyese, teksture të mirë dhe pH neutrale (dobët acidike deri dobët bazike), e të cilës duhet shtuar edhe 2-5 kg/m² treset dhe 15-20 g/m² pleh mineral i kombinuar NPK. Në rast se toka ku mbillet nuk është e përshtatshme duhet të silltet tjetër, që i përbush këto karakteristika në shtresë 15-20 cm. Farat nuk guxojnë të jenë të infektuara me ndonjë sëmundje apo dëmtues. Të gjitha punët duhet të kryhen në pajtim me projektantin dhe në udhëzim të organit mbikqyrës.</p>	m ²	128.25	15.00	1,923.75
5.1.2	<p>Furnizimi, transporti dhe mbjellja e luleve dekoruese-Karafili (double dianthus dynasty red). Fidanet mbillen në prill-maj në distancë 30 x 40 cm, sistem rrenjor mirë i zhvilluar, i përcjellur me dhe. Pra për 1 m² nevojiten 7-8 fidane, të cilët duhet të jenë mirë të zhvilluar dhe të jenë së bashku me dhe. Toka në të cilën mbillet duhet paraprakisht të lavrohet në thellësi 30-40 cm, imtësohet dhe rrafshohet mirë, të jetë e pasur me materie ushqyese, teksture të mirë dhe pH dobët bazike, e të cilës duhet shtuar edhe 2-5 kg/m² treset dhe 15-20 g/m² pleh mineral i kombinuar NPK. Në rast se toka ku mbillet nuk është e përshtatshme duhet të silltet tjetër, që i përbush këto karakteristika në shtresë 15-20 cm. Farat nuk guxojnë të jenë të infektuara me ndonjë sëmundje apo dëmtues. Të gjitha punët duhet të kryhen në pajtim me projektantin dhe në udhëzim të organit mbikqyrës.</p>	copë	20.00	150.00	3,000.00



5.1.3	Furnizimi, transporti dhe mbjellja e luleve dekoruese-Karafili (<i>double dianthus dynasty white blush</i>). Fidanet mbillen në prill-maj në distancë 30 x 40 cm, sistem rrënjor mirë i zhvilluar, i përcjellur me dhe. Pra për 1 m ² nevojiten 7-8 fidane, të cilët duhet të jenë mirë të zhvilluar dhe të jenë së bashku me dhe. Toka në të cilën mbillet duhet paraprakisht të lavrohet në thellësi 30-40 cm, imtësohet dhe rrafshohet mirë, të jetë e pasur me materie ushqyese, teksture të mirë dhe pH dobët bazike, e të cilës duhet shtuar edhe 2 -5 kg/m ² treset dhe 15-20 g/m ² pleh mineral i kombinuar NPK. Në rast se toka ku mbillet nuk është e përshtatshme duhet të silltet dhe që i përbush këto karakteristika në shtresë 15-20 cm. Fidanet nuk guxojnë të jenë të infektuar me ndonjë sëmundje apo dëmtues. Te gjitha punet duhet te kryhen ne pajtim me projektantin dhe ne udhezim te organit mbikqyres.	copë	20.00	150.00	3,000.00
5.1.4	Furnizimi, transporti dhe mbjellja e luleve dekoruese-Impatiens (<i>Impatiens walleriana white</i>). Fidanet mbillen në prill-maj në distancë 30 x 50 cm, sistem rrënjor mirë i zhvilluar, i përcjellur me dhe. Pra për 1 m ² nevojiten 6 fidane, të cilët duhet të jenë mirë të zhvilluar dhe të jenë së bashku me dhe. Toka në të cilën mbillet duhet paraprakisht të lavrohet në thellësi 30-40 cm, imtësohet dhe rrafshohet mirë, të jetë e pasur me materie ushqyese, teksture të mirë dhe pH dobët bazike, e të cilës duhet shtuar edhe 2 -5 kg/m ² treset dhe 15-20 g/m ² pleh mineral i kombinuar NPK. Në rast se toka ku mbillet nuk është e përshtatshme duhet të silltet dhe që i përbush këto karakteristika në shtresë 15-20 cm. Fidanet nuk guxojnë të jenë të infektuar me ndonjë sëmundje apo dëmtues. Te gjitha punet duhet te kryhen ne pajtim me projektantin dhe ne udhezim te organit mbikqyres.	copë	20.00	150.00	3,000.00
5.1.5	Furnizimi, transporti dhe mbjellja e luleve dekoruese-Impatiens (<i>Impatiens walleriana blu</i>). Fidanet mbillen në prill-maj në distancë 30 x 50 cm, sistem rrënjor mirë i zhvilluar, i përcjellur me dhe. Pra për 1 m ² nevojiten 6 fidane, të cilët duhet të jenë mirë të zhvilluar dhe të jenë së bashku me dhe. Toka në të cilën mbillet duhet paraprakisht të lavrohet në thellësi 30-40 cm, imtësohet dhe rrafshohet mirë, të jetë e pasur me materie ushqyese, teksture të mirë dhe pH dobët bazike, e të cilës duhet shtuar edhe 2 -5 kg/m ² treset dhe 15-20 g/m ² pleh mineral i kombinuar NPK. Në rast se toka ku mbillet nuk është e përshtatshme duhet të silltet gjelër, që i përbush këto karakteristika në shtresë 15-20 cm. Fidanet nuk guxojnë të jenë të infektuar me ndonjë sëmundje apo dëmtues. Te gjitha punet duhet te kryhen ne pajtim me projektantin dhe ne udhezim te organit mbikqyres.	copë	20.00	150.00	3,000.00
5.1.6	Furnizimi, transporti dhe mbjellja e drurit dekorativ-Panja (<i>Acer platanoides "Globosum"</i>), me zhvillim 18 muajsh, perimetër të trugut 18-22 cm, sistem rrënjor mirë i zhvilluar, i përcjellur me dhe, dhe i certifikuar. Mbillet në telor-nëntor duke e hapur një grop me dimensione 70x70x70 cm, e e cila mbushet me dhe natyral (marr nga shtresa e sipërme e tokës, 0-25 cm thellësi, i cili ka teksturë lymore, lymore-argjillore ose ranore-argjillore, i pasur me materie ushqyese dhe pH nga dobët acidike deri dobët bazike, përkatësisht 6,1 deri 7,8), i cili paraprakisht përzihet me 1-1,5 kg treset (dhe i luleve) dhe 100-150 g pleh mineral i kombinuar NPK. Bimët nuk guxojnë të jenë të infektuar me ndonjë sëmundje apo dëmtues. Te gjitha punet duhet te kryhen ne pajtim me projektantin dhe ne udhezim te organit mbikqyres.	cope	1.00	500.00	500.00
				Gjithsej pozicioni 5	€ 14,423.75

6 PUNET E INSTALIMEVE ELEKTRIKE					
6.1 Punët e dheut dhe punët ndërtimore					
6.1.1	Hapja e kanaleve me dimensione (60x40)cm për kablo të ndriqimit. Qmimi është dhënë për të gjitha punët duke përfshirë hapjen e kanalit, shtrirjen e rërës, shtrirjen e shiritit me vërejtje, mbylljen e kanalit, ngjeshjen e dheut dhe largimin e dheut të tepërt.	m'	450.00	3.00	1,350.00
6.1.2	Ndërtimi i bazamenteve të betonit me dimensione të përafërta (30x30x40)cm për vendosjen e shtyllave të llapave me ndriçim të ulët me lartësi afër 0,7m. Në këtë pikë janë llogaritur të gjitha punët përgatitore duke përfshirë punimin e kallupeve, vendosjen e betonit të armiruar dhe në fund edhe vendosjen e bulonave për përforsim të shtyllave.	copë	12.00	150.00	1,800.00
6.1.3	Ndërtimi i bazamenteve të betonit me dimensione të përafërta (50x50x600)cm për vendosjen e shtyllave të llapave me ndriçim të mesëm me lartësi afër 3,5m. Në këtë pikë janë llogaritur të gjitha punët përgatitore duke përfshirë punimin e kallupeve, vendosjen e betonit të armiruar dhe në fund edhe vendosjen e bulonave për përforsim të shtyllave.	copë	2.00	150.00	300.00
				Gjithsej pos: 6.1	3,450.00

6.2 Kabllimi					
6.2.1	Furnizimi, bartja, shtrirja, e kabllës për furnizimin e llampave NYY5x16mm ² e alominit. Kabloja përdoret për furnizimin e tabelës së ndriçimit nga tabela ekzistuese furnizuese që ndodhet në vendkalimin e parë në të djathtë kur nisesh nga "Iber Lepenci"	m'	20.00	80.00	1,600.00
6.2.2	Furnizimi, bartja, shtrirja, e kabllës për furnizimin e llampave NYY5x4.0mm ² . Kabloja përdoret për llampat e ndriçimit dekorativ nga toka, ndriçimit të ulët dhe ndriçimit të mesëm. Kabloja para se të shtrihet në kanal duhet të vendosen në gypa fleksibile Ø30 mm.	m'	420.00	23.00	9,660.00
6.2.3	Furnizimi, bartja dhe vendosja e kutive lidhëse (100x100x60)mm me mbrojtje mekanike IP65 në afërsi të llampave. Kutitë shërbejnë për lidhjen e Kabllos NYY5x4.0mm ² me kabllën fleksibile të llampës P/L 3x0,75mm ² . Kjo kuli mbetet nën sipërfaqe të dyshemesë.	copë	47.00	23.00	1,081.00



6.2.4	Furnizimi, bartja dhe vendosja e mbrojtëseve të plastikës për kablrat e shtrira në kanal. Plastikë mbrojtëse kanë formën e shkronjës "V" dhe vendosen 20cm mbi kabllet e shtrirë në kanal për gjatë gjithë gjatësisë së kabllës.	m'	420.00	20.00	8,400.00
6.2.5	Sistemimi i kabllova egzistuese (tensioni I lartë dhe I ulët). Sistimi do të bëhet mbi plafone të lëshuara apo vend të përcaktuar nga projektanti, duke i sistemuar kabllet në kanalina 12x6cm. Pozicioni përfshinë edhe ndërrimin e kabllës, nëse kablloja egzistuesia nuk e ka gjatësinë e duhur që të sistemohet në kanaline.	m'	730.00	25.00	18,250.00
Gjithsej pos: 6.2					38,991.00

6.3	Trupat ndriqes				
6.3.1	Furnizimi, bartja dhe vendosja e llampave dekorative që vendosen në tokë dhe kanë mbrojtje mekanike IP65. Llambat janë të ndërtuara nga inoksi. Janë të tipit LED-6w me dimensione të përafërta Ø68mm. Së bashku me llampë llogaritet edhe trafaja dhe kabla e llampës. Dizajni dhe ngjyra zgjidhet nga projektanti. Produkti duhet të jetë nga vendet e EU.	copë	47.00	50.00	2,350.00
6.3.2	Furnizimi, bartja dhe vendosja e llampave me lartësi 0,7- 1 m me mbrojtje mekanike IP65. Llambat janë të vendosura në shtylla metalike dhe të përforcuara në bazamente betoni. Janë të tipit LED-15w ndërsa shtylla e tyre është e mbrojtur nga korrozioni me proces të plastifikimit. Dizajni dhe ngjyra zgjidhet nga projektanti. Produkti duhet të jetë nga vendet e EU.	copë	12.00	50.00	600.00
6.3.3	Furnizimi, bartja dhe vendosja e llampave me lartësi 3,5m me mbrojtje mekanike IP65. Llambat janë të vendosura në shtylla metalike dhe të përforcuara në bazamente betoni. Janë të tipit LED-50w ndërsa shtylla e tyre është e mbrojtur nga korrozioni me proces të plastifikimit. Dizajni dhe ngjyra zgjidhet nga projektanti. Produkti duhet të jetë nga vendet e EU.	copë	2.00	500.00	1,000.00
6.3.5	Furnizimi dhe montimi i trupave ndriqes LED 20W në tavane në përdhese. Llambat janë të vendosura në plafonin e lëshuar dhe duhet ti përshtaten formës së tavanit. Dizajni dhe ngjyra zgjidhet nga projektanti. Produkti duhet të jetë nga vendet e EU.	copë	45.00	50.00	2,250.00
Gjithsej pos: 6.3					6,200.00

6.4	Përtokëzimi, rrufepëruesi dhe tabela:				
6.4.1	Furnizimi, bartja dhe vendosja e shiritit përtokëzues Fe/Zn 25x4mm për përtokëzimin e shtyllave 0.7-1 m-she dhe 3.5 m-she.	m'	170.00	5.00	850.00
6.4.2	Pjesë lidhëse dhe kryqëzuese nga heku i pandryshkur (stainless steel)	copë	8.00	5.00	40.00
6.4.3	Lidhja e të gjitha llampave në shtylla me shirit tokzues.	copë	10.00	5.00	50.00
6.4.4	Furnizimi e materialit dhe përgatitja e tabelës komanduese të ndriqimit. Tabela përgatitet sipas skemës elektrike që i bashkangjitet projektit. Materiali i përafërt i nevojshëm për këtë tabelë është: Tabela e thatë, kontaktorët, fotoreleja, ndërprerë rrotullues, releja kohore, përqesit, kanalet e mbrendëshme, kleme dhe material tjetër i imët elektrik dhe jo elektrik për këtë tabelë. Për Zona 1 dhe Zona 2	copë	1.00	5,000.00	5,000.00
Gjithsej pos: 6.4					5,940.00


6.5	Matjet dhe dokumentacioni (pë zona 1 dhe Zona 2)				
6.5.1	Matja e sistemit të tokëzimit dhe njoftimi me shkrim.	komplet	1.00	500.00	500.00
6.5.2	Matja e rrezistencës së izolimit të kabllave të përdorura dhe njoftimi me shkrim	komplet	1.00	500.00	500.00
6.5.3	Punimi i dokumentacionit teknik me të gjitha ndryshimet e bëra gjatë punës.	komplet	1.00	1,500.00	1,500.00
Gjithsej pos: 6.5					2,500.00

Gjithsej pozicioni 6: € 57,081.00

7	PUNET E DRENIMIT				
7.1	Punët e dheut				
7.1.1	Gërmimi i kanalit me makine dhe me dore më gjërësi sipas normave dhe standardeve. Punimet e gërmimit dhe hapjes së kanaleve bëhen pas gërmimit të gjërë dhe mbushjeve zhavorike për krijimin e pistes së bazës së rrugës. Në çmim duhet llogaritur edhe transportin e materialit deri në deponin e caktuar min 15 km. Gjërësia e hapjes së kanalit duhet të jetë e mjaftueshme për mundësi të ngjeshjes min. 60 cm.	m²	35.00	5.00	175.00
7.1.2	Planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktësi ±1cm.	m²	200.00	5.00	1,000.00
7.1.3	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe planifikimi i rrës nën, rreth dhe mbi gypa, fraksion 0-16 mm Ngjeshja të bëhet sipas normave DIN, DPR 103%, si dhe përgatitja e bazamentit me beton para vendosjes së Riqolles në forme U	m³	33.00	25.00	825.00
7.2	Punët montuese				
7.2.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar PE SN4 ose PVC për Shkarkime në puselat më të afërta PESN8 OD 125&160	m'	30.00	15.00	450.00
7.3	Punët e betonit dhe punët metalike				
7.3.1	Punimi dhe montimi i Kanal kullimi me grila, çelik i galvanizuar, çelik inox me dim. 3-4cm në lartësi, me hapsirë të poshtem betonare të parafabrikuar me dim min. 25*25cm, në çmim përfshihet pusela kontrolluese e parafab. për pastrim çdo 30m.	m'	248.00	15.00	3,720.00
7.4	Testimi dhe dokumentacioni				
7.4.1	Testimi i gypave dhe punimi i dokumentacionit teknik me të gjitha ndryshimet e bëra gjatë punës.	komplet	1.00	250.00	250.00
Gjithsej pozicioni 7:					€ 6,420.00

8	PUNET E TJERA				
8.1	Punët e izolimit në pasazhe				
8.1.1	Furnizim dhe instalimi i gjeotekstilit 150g/m² në dyshtemenë e pasazheve tek bërthama. Pozicioni përfshinë dy shtresa gjeotekstil , poshtë dhe lart gjeomembranës izoluese.	m²	551.00	2.00	1,102.00
8.1.2	Furnizimi dhe vendosja e shtrësës niveluese në pasazhet tek bërthama t=5-10cm	m²	551.00	5.00	2,755.00

8.1.3	Furnizim dhe instalimi i membranës hidroizoluese PVC me bazë kimike (Polyvinyl Chloride) dhe FPO (Poliolfefina Flexible) me t=1,5mm në hapsirat e berthamës së objekteve, para vendosjes së pllakave teracore. 1.2, pozicioni përfshin saldimin e membranës.	m ²	551.00	12.00	6,612.00
8.2	Furnizimi dhe montimi i plafonit të lëshuar - sistemi "Grillato" në formë të grilave (prej alumini) - katrore të hapura me dimensione 10x10cm dhe thellësi 4cm. Montimi i plafonit të lëshuar të bëhet duke respektuar udhëzimet e prodhuesit. Pozicioni përfshinë edhe konstruksionin mbajtës me profile metalike të të njëjtit prodhues dhe hapjen e vrimave për të gjitha elementet që duhet të montohen në plafon, po ashtu elementet e montuara të janë kopolabile me plafonin. Llogaria në m ² të moduleve të vendosura. Produkti duhet të jetë nga vendet e EU				
8.2.1	Pasazhi No1 në perdhesë.				
8.2.2	Pasazhi No1 në kullm.	m ²	14.00	45.00	630.00
8.2.3	Pasazhi No2 në perdhesë.	m ²	20.00	45.00	900.00
8.2.4	Pasazhi No2 në kullm.	m ²	14.00	45.00	630.00
8.2.5	Pasazhi No3 në perdhesë.	m ²	20.00	45.00	900.00
8.2.6	Pasazhi No3 në kullm.	m ²	14.00	45.00	630.00
		m ²	20.00	45.00	900.00
8.3	Furnizimi dhe montimi i tavaneve të lëshuara (lineare), "Hunter Douglas" apo të ngjajshme, prej alumini (0,7 mm) ose çeliku (0,6 mm), e ngjyrosur me një ngjyrë poliesteri. Tavaneve lineare montohen në nënkonstruksion metalik të fiksuar në bazament të fortë. Gjerësia e panelit: 80mm RAL9003. Gjatësia e panelit: deri në 6000 mm Thellësia e panelit: 15 mm Sistemi special i mbështetjes (ProFix™) për të siguruar të ngurtësim dhe të qëndrueshmëri dhe rezistencë ndaj ngarkesës së erës Peshja e ulët: zvogëloni ngarkesën statike me alumini të lehtë Qasje e lehtë në plenum Pozicioni përfshinë të gjitha elementet që pozicioni të jetë funksional. Produkti duhet të jetë nga vendet e EU				
8.3.1	Pasazhi 1				
8.3.2	Pasazhi 2	m ²	73.12	45.00	3,290.40
8.3.3	Pasazhi 3	m ²	73.12	45.00	3,290.40
8.3.4	Pasazhi 4	m ²	76.83	45.00	3,457.35
8.3.5	Pasazhi 5	m ²	38.03	45.00	1,711.35
8.3.6	Pasazhi 6	m ²	27.02	45.00	1,215.90
8.3.7	Pasazhi 7	m ²	81.76	45.00	3,679.20
		m ²	93.33	45.00	4,199.85
8.4	Furnizimi dhe ngjyrosja e mureve në pasazhe me ngjyrë akrilike. Nuansat caktohen nga projektanti. Pozicioni përfshin gryerjen e ngjyres ekzistuese përmirësimin e sipërfaqes së murit, ngjyrosjen me bazë dhe aplikimin e ngjyres së re. Bojë e bazuar në dispersion uji akrilike për mbrojtjen të betonit, suvajës etj. Karakteristikat: Është i qëndrueshëm në substrate alkaline Është rezistent ndaj rrezeve UV dhe kushteve të tjera atmosferike Parandalon depërtimin e ujit dhe gazrave të dëmshëm në nënshtrësë Ngjitje e shkëlqyer me nënshtrësën Është rezistent ndaj konsumit dhe gërryerjes së lagështisë.				
8.4.1	Pasazhi 1				
8.4.2	Pasazhi 2	m ²	78.48	20.00	1,569.60
8.4.3	Pasazhi 3	m ²	78.48	20.00	1,569.60
8.4.4	Pasazhi 4	m ²	79.27	20.00	1,585.40
8.4.5	Pasazhi 6	m ²	28.80	20.00	576.00
8.4.6	Pasazhi 7	m ²	126.08	20.00	2,521.60
		m ²	164.82	20.00	3,296.40
8.5	Furnizimi dhe betonimi i rampave për persona me aftësi të kufizuar. Pozicioni përfshinë edhe armimin e tyre. Të gjitha punët duhe të egzekutohen në bazë të projektit.	m ³	10.00	200.00	2,000.00
Gjithsej pozicioni B:					€ 49,022.05





SIGURIMI I EKZEKUTIMIT TË TENDERIT

Për: **Komuna e Prishtinës**
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues").

Në emër të: **Beni Construction SH.P.K. , RADIVOJCË Viti**
(në vazhdim "operatori ekonomik").

Titulli i aktivitetit të prokurimit dhe Numri i prokurimit: 101 Rikonstruimi i Platos në lagjen Dardania, rruga Bill Klinton (tek Santea)
616-24-3024-5-1-1

Garancion me kërkesë të parë

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri;

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **Pesedhjetë mijë 50,000.00 €** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivist se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkakuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbetë pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **50,000.00 €** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejt që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin 'e pranimit'.

Kjo siguri është e vlefshme **210** ditë prej **18.06.2024** deri më **14.01.2025**

Garancioni në fjalë skadon tërësisht dhe në mënyrë automatike nëse kërkesa e juaj nuk ka arritur në K.S "SIGKOS" sh.a më së voni deri në datën e shënuar më lartë.



Nënshkrim dhe vula e Garantuesve

Emri i bankës ose i institucionit financiar

K.S. "SIGKOS" Sh.a.

Lagja Kalabria, Kompleksi Riera, Hyrja Z10, Magjistralia
Prishtinë-Shkup, 10000 Prishtinë, Kosovë

Data

18.06.2024